



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	
Nr.Br.No. 01 / 302	
DAT.DT. 18.05.21	
PRISHTINË - A	

KGJK. Nr. 123/2021

Datë: 30 prill 2021

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7 paragraf 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Nexhat Musaj, ish gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë, sipas Raportit të Panelit Hetimor Nr.AD/KGJK/33/2020/ GJTHPE – AD.nr15/2020, të datës 26 mars 2021, pas seancës dëgjimore të mbajtur më datë 30 prill 2021, në pajtim me nenin 14 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenit 19 dhe 20 të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, nxjerr këtë:

V E N D I M

Nexhat Musaj, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë, **nuk është përgjegjës** për shkeljen disiplinore të përcaktuar nga neni 5, paragrafi 2, pika 2.15, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Paneli Hetimor i themeluar me vendimin e Këshillit gjyqësor të Kosovës me numër KGJK.nr.259/2020, të datës 18 nëntor 2020, për lëndën disiplinore Nr.KGJK/33/2020/GJTHPE-AD/GJTHPE, i ka paraqitur Këshillit Gjyqësor të Kosovës raportin mbi hetimin lidhur me shkeljen disiplinore të pretenduar të ish gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Deçan Nexhat Musaj. Ish Gjyqtari Musaj është dyshuar se me datë 03.05.2019, rreth orës 12:30, ka shkuar të vëllai i ankuesit, palës paditëse në lëndën kontestuese C.nr.50/2019, me të cilën ka qen i ngarkuar gjyqtari tani subjekt i hetimit dhe në praninë e ka thënë fjalët “si e ke (ka qenë fjala për avokatin) , mos shpenzo pare kot për avokat se s ka kurrëgjë në këtë punë”. Më këtë veprim subjekti i neunit ish Gjyqtari Nexhat Musaj kishte për të kryer shkelje disiplinore me pakujdesi të rëndë të përcaktuar nga neni 5 par.2, pika 2.15 të Ligjit mbi Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Për ta shqyrtuar këtë çështje disiplinore Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 30 prill 2021, ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore në të cilën morën pjesë Kryesuesi i Panelit Hetimor gjyqtari Behar Ymeri, dhe subjekti i hetimit disiplinore ish gjyqtari Nexhat Musaj.

Kryesuesi i Panelit Hetimor në fillim të seancës dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se qëndron pran raportit mbi faktet dhe provat e mbledhura lidhur me pretendimet e Autoritetit Kompetent.

Ish gjyqtari Nexhat Musaj në seancën dëgjimore, ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e Autoritetit Kompetent se i njëjti ti ketë thënë vëllait të ankuesit “si e ke Kastratin dhe mos shpenzo pare kot për avokat se s ka kurrëgjë në këtë punë”.

Për ta vërtetuar këtë gjendje faktike Këshilli Gjyqësor i Kosovës, administroj provat materiali siç janë: Raporti mbi provat dhe faktet e mbledhura gjatë procedurës hetimore i datës 26 mars 2021; aktvendimet për lëndën konkrete C.nr.50/2019, të datave 01.02.2021, 08.02.2019, 16.0.2019, padinë e datës 26.04.2021, Kopjen e planit C.D.nr.33 i datës 21.04.2016; Certifikata e pronës se Asmon (Isuf) Aliçkaj, të datës 04.04.2016; kontratat e datës 04.04.2016; Aktvendimet e datës 07.11.2017, dhe 14.10.2020; përgjigjen në padi të datës 15.11.2017, dhe procesverbalet për lëndën C.nr.118/17, të datës 04.06.2018, 31.10.2019, 19.11.2019, 25.11.2019 dhe 05.12.2019; kërkesën për aktivizimin e lëndës C.118/2017 të datës 04.06.2018 dhe kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore të datës 11.11.2020 të Autoritetit Kompetent.

Pas vlerësimit të gjitha provave një nga një dhe të gjitha së bashku, Këshilli Gjyqësor i Kosovës vlerësojë se nuk është kontestues fakti se tani subjekti i hetimit ish gjyqtari Nexhat Musaj kishte qenë i ngarkuar me lëndën civile C. Nr. 50/2019, ku paditës ka qeni _____ vëllai i _____

Mirëpo nga provat e administruara përkatësisht nga deklarata e dëshmitarit _____ nuk u arrit të vërtetohej pretendimi i Autoritetit Kompetent se ish gjyqtari Musaj me datë 03.05.2019, rreth orës 12:30, të ketë shkuar tek _____ dhe ti ketë thënë në praninë e dëshmitarit _____ se “si e ke _____, avokatin, e mos shpenzo pare kotë për avokat se s’ka kurrëgjë në këtë punë”, pasi qe i njëjti ne deklaratën e tij të dhëne pranë panelit hetimor te themeluar lidhur me këtë çështje nuk ka pohuar një gjë të tille. Kurse prova tjera që do të mund ta mbështesnin një pretendim nuk pati . Andaj në mungesë të provave të njëjtin nuk e gjeti përgjegjës.

Nga sa u tha me lartë u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.nr.123/2021, datë: 30 prill 2021

Skender ÇOÇAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejt ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- *Armend Berisha, Kryetar, Gjykata Themelore në Pejë;*
- *Nexhat Musaj, ish Gjyqtar, Gjykata Themelore në Prishtinë;*
- *Arkivit.*